

Sistemi personal audio

Udhëzuesi i fillimit të shpejtë

Dëgjimi i muzikës përmes një rrjeti me valë



* 4 5 2 8 3 0 0 1 1 * (1)

©2014 Sony Corporation

CMT-X7CD / CMT-X7CDB

Fillimisht, përgatitni njësinë dhe telekomandën


Përgatitja e telekomandës

Bateria është e instaluar në fabrikë në telekomandë.
Përpara se të përdorni telekomandën për herë të parë, hiqni fletën izoluese të ngjitur te mbajtësi i baterisë.



Ndezja e njësisë

- 1 Lidhni kordonin e rrymës (të dhënë) me pjesën e pasme të njësisë.
- 2 Lidhni kordonin e rrymës me prizën e murit.
- 3 Shtypni I/⏻ për të ndezur njësinë.



Ky Udhëzues i fillimit të shpejtë shpjegon mënyrën e konfigurimit të një rrjeti me valë duke përdorur SongPal* dhe si të dëgjoni muzikë në Xperia™ / iPhone përmes një rrjeti me valë.

Xperia

Për të dëgjuar muzikë në Xperia
▶ Shikoni këtë anë.

iPhone

Për të dëgjuar muzikë në iPhone
▶ Shikoni anën e kundërt.

* SongPal është një aplikacion për të kontrolluar pajisje të ndryshme audio Sony me telefonin tuaj smartphone/iPhone.

Xperia

Lidhja me një rrjet me valë me SongPal

1

Konfirmoni që Xperia të jetë lidhur me rrjetin me valë.

Regjistroni SSID dhe fjalëkalimin e ruterit tuaj në hapësirat më poshtë.

SSID:

Fjalëkalimi:

Për hollësi drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të ruterit tuaj.

2

Instaloni SongPal në telefonin tuaj Xperia, më pas hapni aplikacionin.

Kërkoni "SongPal" në Google Play™ Store.




Pasi të hapet SongPal, ndiqni udhëzimet e aplikacionit.

3

Kryeni një lidhje BLUETOOTH mes njësisë dhe telefonit tuaj Xperia duke ndjekur udhëzimet e aplikacionit.

Prekni shenjë N në njësi me telefonin tuaj Xperia. Prekni dhe mbajeni prekur derisa Xperia të reagojë.




Nëse telefoni juaj Xperia nuk mbështet funksionin NFC, shikoni "Kur NFC nuk është i disponueshëm në telefonin Xperia".


4

Konfiguroni cilësimet Wi-Fi duke ndjekur udhëzimet e aplikacionit.

Vendosni fjalëkalimin që keni regjistruar në hapin 1, më pas trokitni [OK].



Kur të jetë kryer lidhja Wi-Fi, shfaqet ekrani kryesor i SongPal. Mbyllni SongPal, më pas rinisni njësinë.



Dizajni i aplikacionit mund të ndryshojë pa dhënë njoftim.

5


Luani muzikën.

- 1 Hapni aplikacionin [(WALKMAN®)]* në Xperia.



* Xperia juaj mund të mos e ketë aplikacionin [WALKMAN®]. Në këtë rast, nuk mund të përdoret ky funksion.


- 2 Trokitni [HOME], zgjidhni [SONY:CMT-X7xx], më pas filloni riprodhimin.



Në dritaren e ekranit shfaqet "HOME NET" gjatë luajtjes së muzikës.

Kur NFC nuk është i disponueshëm në telefonin Xperia

Përdorni telekomandën për të vendosur njësinë në modalitetin e çiftimit. Në dritaren e ekranit shfaqet statusi i njësisë.




- 1 Shtypni FUNCTION për të zgjedhur "BT AUDIO".
- 2 Shtypni MENU.
- 3 Shtypni ⬆/⬆ për të zgjedhur "BT MENU", më pas shtypni ⏻.
- 4 Shtypni ⬆/⬆ për të zgjedhur "PAIRING", më pas shtypni ⏻.
- 5 Shtypni ⬆/⬆ për të zgjedhur "OK", më pas shtypni ⏻.


Kur në dritaren e ekranit fillon të pulsojë "PAIRING", njësia hyn në modalitetin e çiftimit.

Krijoni një lidhje BLUETOOTH nga telefoni Xperia.

- 1 Trokitni [Open the Bluetooth setting screen] (Hap ekranin e cilësimeve Bluetooth).



- 2 Trokitni [SONY:CMT-X7xx(Bluetooth)].



Vazhdoni te hapi 4.

Lidhja me një rrjet me valë me SongPal

1

Konfirmoni që iPhone të jetë lidhur me rrjetin me valë.

Regjistroni SSID dhe fjalëkalimin e ruterit tuaj në hapësirat më poshtë.

SSID:

Fjalëkalimi:

Për hollësi drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të ruterit tuaj.

2

Instaloni SongPal në telefonin tuaj iPhone, më pas hapni aplikacionin.

Kërkoni "SongPal" në App Store.




Pasi të hapet SongPal, ndiqni udhëzimet e aplikacionit.

3

Vendosni njësinë në modalitetin e çiftimit.

Përdoreni telekomandën për të vendosur njësinë në modalitetin e çiftimit. Në dritaren e ekranit shfaqet statusi i njësisë.




4

Krijoni një lidhje BLUETOOTH nga telefoni iPhone.


- 1 Shtypni FUNCTION për të zgjedhur "BT AUDIO".
- 2 Shtypni MENU.
- 3 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur "BT MENU", më pas shtypni \oplus .
- 4 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur "PAIRING", më pas shtypni \oplus .
- 5 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur "OK", më pas shtypni \oplus .

Kur në dritaren e ekranit fillon të pulsojë "PAIRING", njësia hyn në modalitetin e çiftimit.

- 1 Trokitni [Settings] (Cilësimet) → [Bluetooth].




- 2 Aktivizoni BLUETOOTH.




5

Konfiguroni cilësimet Wi-Fi duke ndjekur udhëzimet e aplikacionit.


- 3 Trokitni [SONY:CMT-X7xx(Bluetooth)].



Vendosni fjalëkalimin që keni regjistruar në hapin 1, më pas trokitni [OK].



Kur të jetë kryer lidhja Wi-Fi, shfaqet ekrani kryesor i SongPal. Mbyllni SongPal, më pas rinisni njësinë.



Dizajni i aplikacionit mund të ndryshojë pa dhënë njoftim.

6


Luani muzikën.

- 1 Rrëshqitni larg nga fundi i ekranit për të shfaqur qendrën e kontrollit.



- 2 Trokitni [AirPlay], zgjidhni [SONY:CMT-X7xx], më pas filloni riprodhimin.


Në dritaren e ekranit shfaqet "AirPlay" gjatë luajtjes së muzikës.



Kryerja e lidhjes me valë me butonin WPS në ruterin LAN me valë

1

Kontrolloni që kabloja e rrjetit (LAN) (nuk jepet) të jetë shkëputur nga njësia, më pas ndizeni njësinë.



Treguesi i gatishmërisë ndizet në të gjelbër dhe fillon të pulsojë në dritaren e ekranit.

Lidhja Wi-Fi mund të kryhet gjithashtu duke përdorur një PC, ose rrjeti mund të jetë me tela. Për detaje, referojuini udhëzimeve të përdorimit.

2

Vendosni njësinë në modalitetin WPS.

- 1 Shtypni MENU për të zgjedhur "NETWORK".
- 2 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur "WPS", më pas shtypni \oplus .
- 3 Kur të shfaqet "OK" në dritaren e ekranit, shtypni \oplus .

"WPS" pulson në dritaren e ekranit.

3

Mbani shtypur butonin WPS* për më shumë se 3 sekonda.



"CONNECT" pulson pasi pulson "WPS" për disa dhjetëra sekonda në dritaren e ekranit të sistemit, pas të cilës ndizet sapo të kryhet lidhja.

* Për hollësi, drejtojuini udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë.

Rreth "SongPal"

Cilësimet e tingullit

Ju mund të personalizoni me lehtësi tingullin, ose të përdorni cilësimet e rekomanduara të Sony "CA+".

Shërbimi muzikor

Ju mund të shijoni një larmi shërbimesh muzikore.

Komandimi i pajisjeve në rrjetin e shtëpisë


Ju mund të luani muzikën e ruajtur në PC ose në serverin DLNA përmes rrjetit.

Përdorimi i një CD-je të futur në njësi, ose një pajisje të lidhur me USB

Ju mund të luani një CD të futur në njësi ose muzikë në një pajisje të lidhur me konektorin USB.


Ajo që mund të kontrolloni me "SongPal" ndryshon në varësi të pajisjes së lidhur. Specifikimet dhe dizajni i aplikacionit mund të ndryshojnë pa dhënë njoftim.

Zgjedhja e pajisjes
Zgjidhni një pajisje të përputhshme "SongPal".



Cilësimet e pajisjes së lidhur
Shfaqen cilësimet të ndryshme tingujsh/rrjeti. Kjo meny mund të shfaqet nga çdo ekran duke rrëshqitur djathtas.

Ekrani kryesor
Shfaq funksionet e pajisjes së zgjedhur, shërbimet muzikore dhe aplikacionet e instaluar në smartphone/iPhone.



Mini-luajtësi
Komanduesi për funksionin e zgjedhur.